




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-1604/20 datë:20.01.2020



Npi – 01/39 datë: 31.01.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 31.01.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -I - TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 31.01.2020 (e premte) në ora 14.00 h. në sallën Nr.01.

Në mbledhje përvèç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: Rrahman Kadrija, Fatmire Ferati, Muhamet Ademaj, Diarta Vishesella, Ruzhdi Brahim i Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri dhe dhe Gazmend Piraj; Nga UNMIK-u Xhavit Fejza dhe Lorent Salihu, qytetarë nga Komuniteti Ashkali, Behxhet Bajrushi dhe Muhamet Mehmeti. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rrahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19.12.2019,
2. Miratimi i orarit të mbledhjeve të Komitetit për vitin 2020,
3. Faktorët ndikues për mos përbushjen e kërkesave të komuniteteve,
4. Aktivitetet për 15 shkurtin, dita e flamurit të komunitetit shkali,
5. Informatë për aktivitetet e ZKKK-së gjatë muajit Janar,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19.12.2019,

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 19.12.2019.**

Pika 2

Miratimi i orarit të mbledhjeve të Komitetit për vitin 2020

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Idajet Rexhepit.

z.Idajet Rexhepi, Zyrtar i Kuvendit; Sqaroi se orari i mbledhjeve të KPK-së është i harmonizuar edhe me oraret e mbledhjeve të Kuvendit dhe KPF-së.

znj.Fatmire Faerati; Përshëndetje, unë nuk kam ndonjë vërejtje për sa i përket orarit, mendoj se është mirë që është harmonizuar edhe me orarin e Kuvendit prandaj mendoj se duhet ta votojmë.

z.Muhamed Ademaj; Edhe unë e përkrahu draftin e këtij orari i cili siç u tha qenka harmonizuar me orarin e Kuvendit, kështu që edhe unë jam për me aprovuar.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE; Përshëndetje, unë e kam vërejt se në mes orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe KPK-së ka një diferencë vetëm një ose dy ditë. Para se me vendos është mirë me e shikuar mundësinë që me pas një afat të mjaftueshmë për me i dhënë rekomandimet për Kuvend.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë mund të them se edhe vitet e më pashme e kemi pas të njëjtën diferencë kohore dhe asnjëherë nuk kemi pas problem, unë po besoj se as tash nuk do të kemi. Në Komitet i kemi edhe anëtarët e Kuvendit të cilët minden me i prezantuar drejtë për drejtë rekomandimet në Kuvend. Në vazhdim konstattoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -I- për vitin 2020, të mbajtur më : 31.01.2020, unanimisht, aprovoi Vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.**

Pika 3

Faktorët ndikues për mos përbushjen e kërkesave të komuniteteve

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, ne si qellim parësor e kemi që rastet që janë më emergjente të plotësohen, mirëpo krejt kjo lidhet me çështjen e buxhetit. Nuk është se kemi ndonjë buxhet të lartë, 6500€ janë të ndara për të gjitha fushat, kjo pra është njëra nga sfidat. Sfidë tjeterë është edhe mos mundësia që to përkrahim pak a shumë dy shoqata të komunitetit pakicë që veprojnë në Shtime "Blindona" dhe "As Stars" pastaj sfidë tjeterë është fakti se një pjesëtari të komunitetit shkali ju ka kall shtëpia e ne nuk po kemi mjete për me i bëtë një zgjidhje të përkohshme. Kemi kërkesa të ndryshme për sa i përket aktiviteteve rimore e që nuk po mundemi me ju dal ndihmë. Çështja e realizimit të kërkesave shkon në procedura mjaft të gjata, si psh. njoftimi i palëve në fushën e shëndetësisë. Sfidë është edhe bashkëpunimi me nivelin qendror, më mirë me thënë mos bashkëpunimi sidomos me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Pastaj kemi rastin e Enver Shabanit i cili që nga viti 2012 nuk i është përfunduar shtëpia e banimit. kemi bashkëpunim shumë të mirë me QPS-në mirëpo edhe ata nuk kanë buxhet.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë po kërkoj edhe nga anëtarët e Kuvendit që janë në këtë Komitet që të angazhohen në Kuvend me qëllim që ta kemi mundësinë që QPS-ja së paku të del me pako ushqimore kohë pas kohe, ata nuk kanë subvencione ndoshta do të ishte mirë që me e shtuar buxhetin te Qendra për Punë Sociale.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE; Kjo që po thoni tash, ndoshta ka pas mundësi me u bërë para aprovimit të buxhetit, sepse edhe përkundër vullnetit të drejtorit nuk e lejojnë procedurat për ndarje të ndihmave të tillë.

znj.Fatmire Ferati; Te pjesa e ndarjes së subvencioneve gjithherë e më shumë po vjen duke u ngushtuar rrathi, dhe buxheti po ngarkohet. Te QPS-ja mendoj se pjesa e pakos ushqimore është têrhequr për shkak të mungesës së buxhetit, tanë duhet me gjet mënyrë se si me i përkrahu.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për raportin, po ashtu faleminderit për këshillat e Muharrem Hazirit, sepse në Shtime kemi mjaft shumë familje skamnore. Nëse i krahasojmë Komunitetet që jetojnë në Shtime me komunat tjera, unë nuk besoj se jam në kushte të mjerueshme. Familjarët nuk duhet vetëm me prit ndihma, sepse gjendja po vjen duke u vështiruar. Kemi shumë familje edhe nga komuniteti shumicë që kanë nevojë për ndihma, mirëpo kjo është gjendja reale që e kemi. Ne realisht jemi për me ju ndihmuar.

z.Arton Demiri; Po ndërlidhem me sfidat që u përmendën e që i ka komuniteti Rom. Qe 5 vite nuk kemi ujë për pije, kjo është një problem shumë i madh për ne. Këtë kërkesë e kam paraqitur edhe më herët por nuk është ndërmarr asgjë.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Sa i përket ujtit për pije ne kemi shpresa të mëdha te organizata “Katari” e cila po ndihmon në hapjen e puseve për nevojtarët që nuk anë mundësi ta hapin vet. Ne po shpresojmë që këtë vit do të bëjmë zgjidhje edhe për lagjen tuaj.

Pika 4

Aktivitetet për 15 shkurtin, dita e Flamurit të komunitetit shkali

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Fjalën për këtë pikë ja dha Behxhet Bajrushit.

z.Behxhet Bajrushi, përfaqësues i OJQ “JRSH” (Jehona Rinore e Shtimes); Përshëndetje, unë jam njëri nga anëtarët e këshillit organizativ për manifestimin e 15 Shkurtit, dita e Flamurit të komunitetit Ashkali. Ne kemi formuar këshillin organizativ si dhe kemi bërë një plan se si do ta organizojmë këtë ditë. Plani ende nuk është në detaje i shkruar por mund të them se në këtë ditë do të organizojmë turnir të vogël të futbollit, tjeter do të kemi program kulturo- artistik, pastaj do të bëhet organizimi i disa skeçeve humoristike. Datat 15 dhe 17 Shkurti janë në kujtesën tonë si data shumë të rëndësishme. Ne nga Komuna po kërkojmë një përkrahje të vogël rreth 480€ për ditën e Flamurit.

z.Muhamet Ademaj; Ju urojmë suksese për organizimin sa më të mirë të ditës së Flamurit. Ne do të bëjmë çka mundemi për me ju ndihmuar.

Pika 5

Informatë për aktivitetet e ZKKK-së gjatë muajit Janar

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Sa i përket kësaj pike unë nuk do ta zgjati shumë, mund ë them se persona të riathesuar gjatë kësaj periudhe nuk ka. Kemi pas dy raste me sëmundje të rënda e që tash për tash nuk po mundemi me ju ndihmuar. Kemi 3 projekte me të cilat do të konkurrojmë në qeveri, faktikisht do ti përsërisim këtë projekte sepse nuk janë aprovuar vitin e kaluar, vlera e këtyre projekteve është rreth 8000€, e që mendojmë se ka mundësi reale për me u realizuar. Kemi bërë një kërkesë te KFOR-i për ndihma në tesha për fëmijë. Buxheti është i bllokuar tanë për tanë. Me IOM-in kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, ne po besojmë që do të na ndihmojnë, mirëpo ne duhet ti identifikojmë fushat në të cilat këta munden me na ndihmuar.

Pika 6

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë desha të ju njoftoj se Bekim Amrushit i ka ndodhur një rast ku ju ka kallë shtëpia e banimit, ndoshta është mirë me organizua një ndihmë sa do të vogël për te, mirëpo shtëpia e tijë ka ardhur deri te kulmi ku duhet falënderuar Hoxhën, Behxhet Bajrushin që ka kontribuar jo vetëm për këtë rast por edhe në disa raste të tjera. Për sa i përket Xhemajl Ilazit nga fshati Gjyrkovc kanë ndihmuar disa persona dhe disa firma të cilat i falënderojmë. Psh. firma “Fortuna” e ka siguruar krejt ngjitësin për krejt shtëpirinë, pastaj firma “STN-Beton” i ka dhënë 7 kubik beton. Familja e deputetit të Kuvendit të Kosovës z.Hetem Arifi i ka dhënë 800 €. Pastaj OJQ “Rahmeti” i ka dhënë 200 €. Kryetari i Komunës z.Naim Ismajli i ka dhënë 4 dyer të dhomave dhe 1 derë për Banje. Firma “Kosova Model” – Koshare ka dhënë dritare në vlerë prej 1000€. Unë kisha kërkuar që të diskutojmë për caktimin e një date për anëtarët e Komitetit për me dalë në teren për vizitë familjeve.

z.nj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, po e caktojmë një datë të përafërt e pastaj ta shohim, sepse ka edhe disa trajnime që janë të parapara. Ndoshta do të ishte mirë që ta caktojmë datën 20.02.2020.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, po lidhem pak te shtëpitë për ndërtim që i përmendi Ibrahimini. Këto pare i ka dhënë Qeveria, po ashtu edhe Kompaninë e ndërtimit e kanë zgjedhur ata, dhe kanë thënë se do ti kryejnë brenda muajit. Në cilin muaj jemi tash, pyetja është pse nuk u kryen. Ti kryesues i komitetit duhet më shumë me këqyrë punën e buxhetit për ZKKK-në. Ti duhet me qenë në kontakt dhe duhet të konsultoheni për secilën çështje me neve anëtarët e Komitetit. Kemi shumë probleme, kemi njerëz me sëmundje të rënda, kemi shumë skamnorë, nuk ka punësim, a mundemi me i përballuar të gjitha këto probleme.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15.29 h.

Procesmbajtës
Idajet/Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija